



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Korçe

Sektori i Integritit European

Nr _____ Prot

Korçë më _____

RELACION

Për miratimin e Pjesëmarrjes së Bashkisë Korçë në zbatimin e Projektit “RISTOR- Rural Innovation centers for Sustainable and inclusive TOuRism ” në kuadër të programit Interreg VI-A IPA Greqi- Shqipëri 2021-2027 si dhe miratimin e fondeve si pjesë e buxhetit të Bashkisë

Në kuadër të programit Interreg VI-A IPA Greqi – Shqipëri 2021-2027 si dhe në përputhje me prioritetet e Bashkisë Korçë për zhvillim të qëndrueshëm, forcim të kohezionit social dhe rritje të potencialit turistik të zonave tona rurale, Bashkia Korçë ka fituar projektin ndërkufitar “Rural Innovation centers for Sustainable and inclusive TOuRism -RISTOR” (Qendra të Inovacionit Rural për Turizëm të Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës).

Ky projekt bashkon pesë partnerë nga Greqia dhe Shqipëria, një prej të cilëve është dhe Bashkia Korçë, për të adresuar sfidat e përbashkëta të rajonit të Zagorisë Lindore (GR) dhe rajonit të Korçës (AL) – dy zona të pasura me kulturë dhe natyrë, por ende të pazhvilluara në krahasim me destinacionet fqinje.

Qëllimi i projektit është rigjallërimi i dy godinave – njëra në fshatin Demati (Zagori) dhe një në fshatin Dardhë (Korçë) – duke i shndërruar ato në **Qendra të Qëndrueshme dhe Gjithëpërfshirëse të Turizmit**. Restaurimi i tyre do të kryhet duke respektuar arkitekturën lokale dhe metodat tradicionale të ndërtimit.

Pas vënies në funksion, këto qendra do të shërbejnë si hapësira bashkëpunimi ndërkufitar ku komunitetet lokale, profesionistët dhe vizitorët do të mblidhen për të ndarë dije, për të ndërtuar aftësi dhe për të bashkëkrijuar të ardhmen e turizmit të qëndrueshëm në rajon.

Aktivitetet kryesore të projektit përfshijnë:

- Programe trajnimi për profesionistë lokalë në fushën e turizmit të qëndrueshëm.
- Shërbime inkubacioni për ide dhe biznese të reja turistike.

- Krijimin e ofertave të reja turistike (kulturore, rurale, agro-turizëm, aventurë, familjare).
- Organizimin e aktiviteteve të rrjetëzimit dhe shkëmbimit të përvojave përtej kufijve.
- Angazhimin e të rinjve, grave, familjeve, krijuesve dhe prodhuesve të vegjël si përfitues dhe bashkëkrijues të produkteve të reja.

Gjithashtu, projekti do të krijojë **një komunitet digjital** profesionistësh në Greqi dhe Shqipëri, duke përdorur kanalet e mediave sociale për promovimin e mundësive dhe nxitjen e dialogut të hapur ndërkufitar.

Në këtë mënyrë, projekti **RISTOR** do të pozicionojë Dardhën dhe Dematin si destinacione të vizitueshme gjatë gjithë vitit, të rrënjosura në identitetin kulturor, qëndrueshmëri dhe aksesueshmëri, duke treguar se si përdorimi adaptiv i infrastrukturës publike, fuqizimi i komunitetit dhe bashkëpunimi ndërkufitar mund t'i japin jetë të re zonave rurale dhe të ndikojnë në zhillimin e tyre ekonomik

Duke u bazuar në Nenin 25 pika 2 dhe neni 54 germa dh) i ligjit 139/2015 " Per vetqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; në ligjin nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë"; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 24.9.2010 "Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë"; në VKB nr. 176 datë 26.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë", si dhe në pikën 3.3 të Udhëzimit nr.10 datë 12.7.2024 "Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", kërkojmë miratimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Korçë në zbatimin e projektit, autorizimin për Kryetarin e Bashkisë Korçë si përfaqësuesin e vetëm ligjor për firmosjen e çdo lloj dokumenti lidhur me projektin "RISTOR" si dhe miratimin për të bërë pjesë të buxhetit të bashkisë fondin nga financimi i huaj prej 175,352 Euro/ 16,993,362 ALL, me këtë strukturë buxhetore:

SHTOHET AC122 00 Art. 602000 02 +7,874,907 lekë (Prog. Mbështetja e Zhvillimit Ekonomik, Bashkia)

SHTOHET AC122 00 Art. 2310000 02 +9,118,455 lekë (Prog Mbështetja e Zhvillimit Ekonomik, Bashkia)

Buxheti i projektit në total është i ndarë sipas zërave më poshtë:

PB2 Bashkia Korce							
Njesia	Kosto stafi	Zyrë & administrim	Udhëtim & dieta	Ekspertizë e jashtme & shërbime	Pajisje	Infrastruktura & punime	Totali
Euro	22,000	3,300	3,300	77,960	16,500	96,130	219,190
Lek	2,132,020	319,803	319,803	7,555,104	1,599,015	9,315,958	21,241,703

Burimet e financimit të totalit të projektit janë në raportet 80% - kontribut nga Bashkimi European dhe 20% kontribut nga fondet e bashkisë. Tabela më poshtë reflekton burimet e financimit:

PB2 Bashkia Korçe								
	Kosto stafi	Zyrë & administrim	Udhëtim & dieta	Ekspertizë e jashtme & shërbime	Pajisje	Infrastruktura & punime	Totali euro	Totali Lek
Kontribut i financimit të huaj 80%	0	0	3,300	77,960	16,500	77,592	175,352	16,993,362
Kontribut i Bashkisë 20%	22,000	3,300	0	0	0	18,538	43,838	4,248,341
Totali euro	22,000	3,300	3,300	77,960	16,500	96,130	219,190	21,241,703

Vlera e kontributit të bashkisë prej **4,248,341** lek, përfshin tre zërat e mëposhtëm:

1. Kosto stafi për vlerën 2,132,020 ALL, është kontribut në natyrë i bashkisë.
2. Zyrë dhe administrim për vlerën 319,803 ALL, është kontribut në natyrë i bashkisë
3. Infrastruktura dhe punime për vlerën 1,796,518 ALL është kontribut në vlerë i bashkisë për punimet në infrastrukturë. Ky fond do të parashikohet në buxhetin e Bashkisë për vitin 2026.

Shenim:

Konvertimi nga euro në lek është bërë me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 15.09.2025, 1euro = 96.91 lek . Buxheti në lek ndryshon gjatë zbatimit të projektit sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën kur kryhet shpenzimi.

SEKTORI I INTEGRIMIT EUROPIAN

Aida KRISTO

DREJTORIA E FINANCES
BUXHETIT DHE MFK

Valbona ZIKO

DREJTORIA E PËRGJITHSHME
JURIDIKE DHE TË MENAXHIMIT TË
BURIMEVE NJERËZORE

Anxhela QERAMIXHI (DISHNICA)

KRYETARI

Sotiraq FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

P/V E N D I M

Nr. Datë

Për miratimin e Pjesëmarrjes së Bashkisë Korçë në zbatimin e Projektit “RISTOR- Rural Innovation centers for Sustainable and inclusive TOurism -RISTOR” në kuadër të programit Interreg VI-A IPA Greqi- Shqipëri 2021-2027 si dhe miratimin e fondeve si pjesë e buxhetit të Bashkisë

Duke u bazuar në Nenin 25 pika 2 dhe neni 54 germa dh) i ligjit 139/2015 " Per vetqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; në ligjin nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 24.9.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”; në VKB nr. 176 datë 26.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë”, si dhe në pikën 3.3 të Udhëzimit nr.10 datë 12.7.2024 “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”:

VENDOSI

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Bashkisë Korçë në zbatimin e projektit “RISTOR- Rural Innovation centers for Sustainable and inclusive TOurism -RISTOR” në kuadër të programit Interreg VI-A IPA Greqi- Shqipëri 2021-2027
2. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë si përfaqësuesin e vetëm ligjor për firmosjen e çdo lloj dokumenti lidhur me këtë projekt.
3. Të miratojë financimin e huaj të projektit RISTOR në vlerën 16,993,362 lekë si pjesë të buxhetit të bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

SHTOHET AC122 00 Art. 6020000 02 +7,874,907 lekë (Prog. Mbështetja e Zhvillimit Ekonomik, Bashkia)

SHTOHET AC122 00 Art. 2310000 02 +9,118,455 lekë (Prog Mbështetja e Zhvillimit Ekonomik, Bashkia)

Buxheti i projektit në total është i ndarë sipas zërave më poshtë:

PB2 Bashkia Korce							
Njesia	Kosto stafi	Zyrë & administrim	Udhëtim & dieta	Ekspertizë e jashtme & shërbime	Pajisje	Infrastruktura & punime	Totali
Euro	22,000	3,300	3,300	77,960	16,500	96,130	219,190
Lek	2,132,020	319,803	319,803	7,555,104	1,599,015	9,315,958	21,241,703

Burimet e financimit të totalit të projektit janë në raportet 80% - kontribut nga Bashkimi Europian dhe 20% kontribut nga fondet e bashkisë. Tabela më poshtë reflekton burimet e financimit:

PB2 Bashkia Korce								
	Kosto stafi	Zyrë & administrim	Udhëtim & dieta	Ekspertizë e jashtme & shërbime	Pajisje	Infrastruktura & punime	Totali euro	Totali Lek
Kontribut i financimit të huaj 80%	0	0	3,300	77,960	16,500	77,592	175,352	16,993,362
Kontribut i Bashkisë 20%	22,000	3,300	0	0	0	18,538	43,838	4,248,341
Totali euro	22,000	3,300	3,300	77,960	16,500	96,130	219,190	21,241,703

- Vlera e kontributit të bashkisë prej **4,248,341** lek, përfshin tre zërat e mëposhtëm:
 - Kosto stafi për vlerën 2,132,020 ALL, është kontribut në natyrë i bashkisë.
 - Zyrë dhe administrim për vlerën 319,803 ALL, është kontribut në natyrë i bashkisë
 - Infrastruktura dhe punime për vlerën 1,796,518 ALL është kontribut në vlerë i bashkisë për punimet në infrastrukturë. Ky fond do të parashikohet në buxhetin e Bashkisë për vitin 2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK si dhe Sektori i Integritetit Europian.
 5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit 139/2015 " Per vetqeverisjen vendore", i ndryshuar

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETAR

Ana Verushi

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____